

VENDIM
Nr.5, datë 26.1.2007

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT TË SHITJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-ET ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW**

Në mbështetje të neneve 26, pika 1, dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Bordi Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.1.2007, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për metodën e përcaktimit të çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW,

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW (metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.6, datë 23.5.2002 “Për miratimin e procedurave të vendosjes dhe rishikimit të çmimeve në kompanitë e licencuara” dhe vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.60, datë 29.12.2004 “Të dhënat bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

**METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË ÇMIMIT TË UNIFIKUAR TË SHITJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË LICENCUARIT, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË NGA HEC-ET ME FUQI TË
INSTALUAR DERI NË 10 MW**

Autoriteti

Metodologjia e llogaritjes së çmimit unik për shitjen e energjisë elektrike të prodhuar për të licencuarit, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW, është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (me të gjitha ndryshimet).

Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është të përcaktojë një çmim unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW, bazuar në rolin dhe përgjegjësitë e ERE-s për: (i) nxitjen e efikasitetit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të të licencuarve; (ii) nxitjen e investimeve të reja si në zgjerimin e burimeve ekzistuese, ashtu dhe në burime të reja në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike, duke rritur transparencën e procesit, mosdiskriminimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë për pjesëmarrjen e sektorit privat në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

1. Termat e përdorur në metodologji

Termat e përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin si më poshtë:

1.1 Çmimi unik – çmimi i njëjtë i shitjes së energjisë elektrike, i përcaktuar nga ERE sipas kësaj metodologjie, për të licencuarit, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW.

1.2 Çmimi mesatar i shitjes me pakicë të klientët tariforë në shpërndarje – çmimi i përcaktuar nga ERE për periudhën për të cilën përcaktohet çmimi unik, që merr në konsideratë strukturën e shitjes së parashikuar në aplikimin e KESH-it sh.a. për rishikimin e çmimeve të shitjes me pakicë për të njëjtën periudhë.

1.3 Klientët tariforë në shpërndarje – klientët fundorë që nuk janë klientë të kualifikuar, që furnizohen nga KESH sh.a. në TM dhe TU.

2. Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

2.1 Kjo metodologji është hartuar mbështetur në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (me të gjitha ndryshimet), aktet e tjera ligjore që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga ERE.

2.2 Energjia elektrike e prodhuar nga të licencuarit, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW, injektohet direkt në rrjetin TM/TU në shpërndarje), blihet nga KESH sh.a. me qëllim rishitjeje të klientët tariforë që furnizohen në rrjetin e shpërndarjes.

2.3 Çmimi unik llogaritet duke iu referuar çmimit mesatar të shitjes me pakicë të energjisë elektrike të klientët tariforë që furnizohen në rrjetin e shpërndarjes.

2.4 Çmimi unik, sipas kësaj metodologjie, do të rregullohet në funksion të ndryshimeve të çmimit mesatar të shitjes me pakicë të energjisë elektrike të klientët tariforë në shpërndarje të tarifës së shërbimit të transmetimit, si dhe të nivelit të humbjeve teknike në shpërndarje të pranuar nga ERE, për qëllim të përcaktimit të çmimit unik.

2.5 Çmimi unik llogaritet për të gjithë prodhuesit e licencuar nga ERE për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW.

3. Formula e llogaritjes së çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW

3.1 Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW, përcaktohet nga ERE.

3.2 Për të gjithë të licencuarit, për prodhimin të energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW, çmimi unik llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$P_U = (P_R - P_T) * (1 - L_D \%)$$

ku:

P_U – Çmimi unik i prodhuesve me fuqi të instaluar deri në 10 MW.

P_R – Çmimi mesatar i shitjes me pakicë i energjisë elektrike të klientët tariforë në shpërndarje.

P_T – Tarifa e shërbimit të transmetimit, e miratuar nga ERE.

$L_D\%$ - % e humbjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes e pranuar nga ERE për efekt të llogaritjes së çmimit unik sipas kësaj formule.

4. Dispozita përfundimtare

Metodologjia e llogaritjes së çmimit unik për prodhuesit me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të licencuar nga ERE për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, u miratua nga Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike me vendimin nr.5, datë 26.1.2007.